



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR "DEMOKRAT"



*Shërbimi i
seancave plenare
28/01/2020
Vazhdimi i
[signature]*

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2020

Lënda : Propozim amendamenti

Drejtuar : KRYETARIT TË KUVENDIT

Z. Gramoz RUÇI

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e deputetit dhe zëvendëskryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe të anëtarit të Grupit Parlamentar "Demokrat", propozoj që në projektligjin "Për Dhënie Amnistie", të bëhen ndryshimet si më poshtë:

I. Në nenin 1 të projektligjit, propozoj amendimin si më poshtë vijon:

- Në pikën 1, të nenit 1 të projektligjit pas fjalëve: "*Qëllimi i këtij ligji është të përjashtojë nga*", propozoj të shtohen këto fjalë me këtë përmbajtje: **ndjekja penale deri në vuajtjen e dënimit ...**

II. Në nenin 2 të projektligjit, propozoj amendimet si më poshtë vijon:

- Propozoj të spostohet pika 1, duke shtuar një fjali në pikën 1, me këtë përmbajtje:

1. "Person nën hetim konsiderohet:

personi ndaj të cilit zhvillohen hetime nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, sepse dyshohet si autori i një veprë penale, brenda datës 30.09.2019".

- Propozoj të spostohet pika 2, duke shtuar 4 fjali, ndarë në 4 gërma, a, b, c, d, në pikën 2, me këtë përmbajtje:

2. “I pandehur konsiderohet:

- a. personi që akuzohet se ka kryer një vepër penale, nëpërmjet aktit të njoftimit të akuzës që përmban të dhëna të mjaftueshme, të cilat tregojnë se ky është autori i veprës penale, çështja e të cilit ka qenë duke u gjykuar pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe pranë Gjykatave të Shkallës së Parë për Krimet e Rënda brenda datës 31.12.2019.
- b. personi që akuzohet se ka kryer një vepër penale, çështja e të cilit ka qenë duke u gjykuar pranë Gjykatave respektive të Apelit deri në datën 31.12.2019.
- c. personi që akuzohet se ka kryer një vepër penale deri në datën 31.07.2017, çështja e të cilit ka qenë duke u gjykuar nga Gjykata e Lartë.
- d. personi që akuzohet se ka kryer një vepër penale deri në datën 31.07.2017, çështja e të cilit ka qenë duke u gjykuar nga Gjykata e Lartë, kur kjo e fundit ka gjykuar si Shkallë e Parë.

- Propozoj të spostohet pika 1 e nenit 2 të projektligjit me pikën 3 të nenit 2 të tij, pa ndryshime.
- Propozoj të spostohet pika 2 e nenit 2 të projektligjit me pikën 4 të nenit 2 të tij, pa ndryshime.

III. Në nenin 3 të projektligjit, propozoj amendimet si më poshtë vijon:

- Në pikën 1, pas fjalëve: “*Amnistohen personat meshkuj*” propozoj të shtohen këto fjalë me këtë përmbajtje: **të cilët kanë qenë nën hetim, janë marrë si të pandehur ose janë...**

në pikën 1 pas fjalëve: “*dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë*”, propozoj të shtohen këto fjalë me këtë përmbajtje: **për veprat penale që parashikohen sipas Kodit Penal ose është dhënë dënimi...**

në pikën 1 pas fjalëve: “*duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim*” propozoj të shtohen këto fjalë me këtë përmbajtje: **për hetime, procese gjyqësore apo ...**

- Në pikën 2, pas fjalëve: “*Amnistohen personat femra dhe të mitur*” propozoj të shtohen këto fjalë me këtë përmbajtje: **të cilët kanë qenë nën hetim, janë marrë si të pandehur ose janë...**

në pikën 2, pas fjalëve: “*dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë*”, propozoj të shtohen këto fjalë me këtë përmbajtje: **për veprat penale që parashikohen nga Kodi Penal ose është dhënë dënimi...**

në pikën 2, pas fjalëve: “*duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim*” propozoj të shtohen këto fjalë me këtë përmbajtje: **për hetime, procese gjyqësore apo ...**

Duke ju falenderuar,

DEPUTETËT PROPOZUES

Halit Vëlleri
Muslim Murriçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

Grupi Parlamentar Demokrat

RELACION SHPJEGUES NË FUNKSION TË AMENDIMEVE TË PROJEKTLIGJIT “PËR DHËNIE AMNISTIE”

Bazuar në projektligjin “Për Dhënie Amnistie”, unë, deputeti Myslim Murrizi, ju kam paraqitur amendimet që unë i konsideroj të rëndësishme.

Amnistia konsiston në faljen e dënimit që ka marrë formë të prerë në kuptimin e ngushtë dhe të lirimit nga ndjekja penale dhe dënimit në kuptimin e gjerë të saj.

Pra, amnistia është akt në formë të ligjit nëpërmjet të cilit, një numuri të pacaktuar personash u jepet lirimi nga ndjekja penale, lirimi i pjesshëm ose i plotë nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësimi i dënimit aktual në dënim më të butë ose shlyerja tërësisht e dënimit të mbetur.

Në nenin 1 të projektligjit është e rëndësishme që veç personave të dënuar, pjesë e përfitimit nga kjo amnisti të jenë dhe personat që ndiqen penalisht për një vepër penale sipas së cilës parashikohet dënimi deri në 2 vjet.

Në funksion të kësaj, cila do të ishte logjika kur për të njëjtën vepër penale, një person, vendimi i të cilit ka marrë formë të prerë, të amnistohet, ndërsa personi tjetër, i cili është akoma në pritje të vendimit të formës së prerë, pas shpalljes fajtor për një dënim deri në 2 vjet të vuajë dënimin?

Gjithashtu në nenin 2, dhe nenin 3 bëhen amendimet duke përfshirë veç të dënuarve me vendim të formës së prerë edhe personave që janë nën hetim, ose në proces gjyqësor për një vepër penale që parashikon dënim deri në 2 vjet.

Në rast se ky amendim nuk do të miratohet, atëherë ndodhemi përpara zbatimit të një amnistie të ngushtë, dhe përfitimi i personave në funksion të saj do të ishte relativisht i vogël në numër, gjë që bën të humbasë qëllimin kryesor dhënia e saj.

DEPUTETI I GRUPIT PARLAMENTAR “DEMOKRAT”
Myslim MURRIZI